



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Rufki Suma , Kryetar i komunës

Adresa: Rr.Nuri Bushi, Han i Elezit, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Hanit të Elezit (Hani i Elezit), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Hanit të Elezit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Hani i Elezit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Pagesat bazuar në vendime gjyqësore në shumë prej 4,124€ ishin paguar dhe regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Këto pagesa ishin për tri paga përcjellëse të dala nga marrëveshja kolektive e arsimit, të cilat ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Hanit të Elezit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Hanit të Elezit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Hanit të Elezit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Hanit të Elezit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Hanit të Elezit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2020 ishin në vlerë 230,239€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte rënie të hyrave për 67,016€ krahasuar me vitin paraprak e që në këtë kishte ndikuar pandemia Covid 19. Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte në shumë 13,861€, prej tyre të hyrat nga dënimet në trafik ishin 13,623€ dhe agjencia e pyjeve 238€.

Çështja A1 - Mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore

Gjetja

Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20%, e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës. Poashtu sipas nenit 31, pika 6, të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar. Ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Komuna kishte 2,865 prona të regjistruara, mirëpo, sikurse edhe në vitin paraprak, asnjëra prej tyre nuk ishte verifikuar gjatë vitit 2020; dhe
- Në vitin 2020 komuna kishte pranuar 95 ankesa (44 objekte dhe 51 parcela) për tatimin në pronë, ku 83 prej tyre ishin aprovuar në favor të tatimpaguesve. Përderisa kishte vonesa në shqyrtimin e ankesave, ku në tri mostrat e testuara kishin vonesë mbi 4 muaj.

Mosverifikimi i pronave dhe trajtimi me vonesë i ankesave kishin ndodhë për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19, duke pasur parasysh se një kohë zyrtarët kanë qenë në izolim, pastaj është punuar me reduktime. Poashtu Komuna e Hanit të Elezit nuk kishte zyrtar të kontraktuar për tatim në pronë, vetëm zyrtar me detyrë shtesë.

Ndikimi

Mosverifikimi i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë. Vonesat në trajtimin e ankesave ndikojnë në mos azhurnimin e informatave në kohë për vlerësimin e duhur të tatimi në pronë.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore si dhe të shtojë kontrollet duke siguruar personel të Tatimit në Pronë që të bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV-të e vitit 2020 ishte 16,653,238€ kurse e pasurive jokapitale 188,736€ dhe stoqe në vlerë 25,397€. Ne testuam 70 mostra për teste substanciale. Po ashtu, kemi vlerësuar procesin e përgjithshëm të menaxhimit të pasurive, inventarizimin e pasurive dhe mirëmbajtjen e regjistrave të pasurive të komunës.

Çështja A2 - Mos funksionalizimi i sistemit e- Pasuria dhe shpalosje jo e saktë e pasurive jokapitale

Gjetja

Rregullorja MF-nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton në mënyrë të qartë që pasuritë nën 1,000€ duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria". Ne kemi identifikuar mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive nën 1,000€ dhe shpalosjen e tyre në PFV si në vijim:

Pasuritë e blera nën 1,000€ gjatë vitit 2020 nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria. Shpalosja e pasurive jo kapitale në PFV ishte bërë sipas vlerës së vitit paraprak duke mos i përfshirë edhe blerjet e vitit aktual. Sipas evidencave të thesarit shpenzimet (kodet e pasurive nën 1,000€) për vitin 2020 ishin në shumë 43,254€;

Sipas zyrtarëve të komunës sistemi i e-pasurisë ka qenë jo funksional dhe nuk kanë mundur të gjenerojnë raportet e pasurive. Komuna nuk ka mbajtur regjistra të brendshëm për pasuritë jokapitale.

Sipas zyrtarëve të komunës sistemi i e-pasurisë ka qenë jo funksional dhe nuk kanë mundur të gjenerojnë raportet e pasurive. Evidenca interne nuk janë mbajtur për të pasur një pasqyrë të saktë të pasurive nën 1,000€.

Ndikimi

Menaxhimi i dobët i pasurive jokapitale ka ndikuar në shpalosjen jo të saktë të pasurive e që për pasojë kemi një nënvlerësim të pasurive në PFV. Mangësitë e identifikuar, po ashtu ndikojnë që menaxhmenti të mos ketë informatat e sakta për gjendjen e pasurive që janë në dispozicion të komunës duke i vështirësuar marrjen e vendimeve të duhura për investime të reja për pasuri

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë regjistruar në regjistra dhe janë shpalosur saktë në PFV, në pajtueshmëri me kërkesat ligjore .

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,742,094.18	3,277,468.59	3,087,211.70	3,133,209.26	2,861,152.79
Grante Qeveritare - Buxheti	2,424,229.18	2,744,589.26	2,710,574.25	2,582,109.40	2,463,145.41
Financimi përmes huamarrjes	0.00	17,955.00	17,955.00	5,881.78	2,822.75
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	85,891.91	84,716.27	169,163.28	138,389.51
Të hyrat vetanake	317,865.00	317,865.00	187,495.58	259,569.20	171,825.12
Donacionet vendore	0.00	30.00	0.00	54,970.00	55,000.00
Donacionet e jashtme	0.00	111,137.42	86,470.60	61,515.60	29,970.00

Rritja e buxhetit final në raport me buxhetin fillestar ishte në shumë 535,375€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së buxhetit me rishikim prej 45,000€, me vendime të qeverisë prej 293,317€ dhe të hyrave të bartura nga vitet paraprake 85,891€, dhe nga donacioneve në vlerë prej 111,167€.

Në vitin 2020 komuna ka shpenzuar 94% të buxhetit përfundimtar me një rënie prej 4% krahasuar me realizimin e buxhetit 2019 (98%). Realizimi i buxhetit ishte në nivel të kënaqshëm nëpër kategori ekonomike dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	2,742,094.18	3,277,468.59	3,087,211.70	3,133,209.26	2,861,152.79
Pagat dhe mëditjet	1,519,196.00	1,584,766.70	1,577,266.70	1,478,773.44	1,451,063.92
Mallrat dhe shërbimet	303,236.00	436,366.99	382,355.03	261,825.95	226,206.02
Komunalitë	60,000.00	62,000.00	61,959.21	54,368.73	44,405.31
Subvencionet dhe transferet	61,104.00	161,240.87	155,945.50	66,103.40	47,658.80
Investimet Kapitale	629,772.18	1,033,093.21	909,685.26	1,272,137.74	1,091,818.74
Rezervat	168,786.00	0.82	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 65,571€ prej tyre 52,000€ ishin si rezultat i buxhetit të rishikuar, vendimit të qeverisë nr.06/38 shuma prej 6,980€, nga grantet e përcaktuara të donatoreve 18,000€ ndërsa shuma prej 11,409€ ishte reduktuar si kursime në bazë të vendimit nr.08/50. Buxheti për këtë kategori ishte shpenzuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 133,131€. Prej tyre 13,000€, me vendim të kuvendit komunal nr.01/5342/2020, 14,785€ ishte transferuar nga kategoria e rezervave, 79,000€ për zbatimin e rimëkëmbjes ekonomike, 12,424€ nga te hyrat e bartura dhe 13,922€ nga grantet e përcaktuara të donatorëve. Buxheti për këtë kategori ishte shpenzuar 88%; Buxheti final për komunalitë ishte rritur për 2,000€ me rishikim të buxhetit dhe ishte shpenzuar 100%;
- Buxheti final për subvencione ishte rritur për 100,137€. Prej tyre 80,000 me vendimin e qeverisë nr.01/23 për rimëkëmbje ekonomike dhe 20,137€ nga te hyrat e bartura vetanake. Buxheti i shpenzuar për këtë kategori ishte 96%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 403,321€. Prej tyre 131,991€ ishin transferuar me vendimin komunal nr.01/5342/2020 nga kategoria e rezervave, nga programi i rimëkëmbjes 138,000€, nga te hyrat e bartura 53,330 dhe 80,000€ nga grantet e përcaktuara të donatorëve. Buxheti i shpenzuar për kategori ishte 88%.


Komuna për menaxhimin e pandemisë Covid-19 kishte shpenzuar buxhet në vlerë prej 202,122€, prej tyre 65,940€ ishin shtesa në paga, 56,182€ mallra dhe shërbime si dhe 80,000€ ishin për subvencione.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Shpenzimet në tri vitet e fundit nuk kanë ndonjë lëvizje të theksuar nëpër vite, me përjashtim që në vitin e fundit kemi një rritje të shpenzimeve edhe si pasojë e ndikimit të pandemisë Covid 19, pasi i ishte ndarë komunës buxhet shtesë nga niveli qendror.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Siç vërehet nga grafiku shpenzimet më të larta apo 51% i takojnë pagave e mëditjeve, kurse pjesa prej 49% i përbëjnë kategoritë tjera

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2020 ishin në vlerë 230,239€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte rënie të hyrave për 67,016€ krahasuar me vitin paraprak e që në këtë kishte ndikuar pandemia Covid 19. Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte në shumë 13,861€, prej tyre të hyrat nga dënimet në trafik ishin 13,623€ dhe agjencia e pyjeve 238€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	317,865.00	317,865.00	230,238.85	297,254.51	288,495.74
Të hyrat tatimore	148,790.00	148,790.00	97,071.13	117,792.71	133,801.13
Të hyrat jo tatimore	169,075.00	169,075.00	133,167.72	179,461.80	154,694.61

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të komunës së Hanit të Eleyit ka rezultuar me 7 (shtatë) rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, 5 (pesë) rekomandime janë zbatuar, 1 (një) nuk aplikohet më dhe 1 (një) pjesërisht, siç është paraqitur në Grafikon 3, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 3. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak





Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që në bashkëpunim me departamentin e tatimit në pronë në Ministrinë e Financave, të bëj rishikimin e raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm të pronave për komunën, në mënyrë që të përfshihen të gjitha emërtimet e rrugëve nëpër zona. Po ashtu duhet të evidentohen dhe korrigjohen gabimet të cilat kanë të bëjnë me të dhënat e tatimpaguesve në sistem, në mënyrë që kalkulimi i tatimit të jetë i saktë.	Komuna me datën 17.06.2020 ka hartuar një raport për zbritjet e tatimit për banimit primar ndërsa parcelat janë identifikuar në bazë të zonave. nga departamenti i tatimit në pronë.	I zbatuar

2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të përcaktohen dhe aprovohen me rregullore siç parashihet në ligj. Po ashtu para se të nënshkruhen kontratat e reja, të gjithë qiramarrësit/shfrytëzuesit e pronave duhet ti kryejnë obligimet paraprake kontraktuale.	Komuna ka aprovuar rregulloren e brendshme..	I zbatuar
3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të siguroj se MShV përdorën vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në Ministri të Financave gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.	Nuk kemi hasur ndonjë rast të tillë	I zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të inicojë rishikimin e organogramit të komunës për të siguruar se në të është përfshirë edhe pozita e zyrtarit certifikues. Njëherit duhet buxhetuar edhe mjetet financiare për këtë pozitë, në mënyrë që të plotësohen kërkesat ligjore për plotësimin e kësaj pozite.	Pozita me zyrtar certifikues ishte plotësuar	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestinimi i mjeteve kur është e nevojshme) dhe pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate. Blerja e shërbimeve duhet të bëhet përmes procedurave të prokurimit dhe kontratat të nënshkruhen nga menaxheri i prokurimit	Pagesat për vendime gjyqësore nuk janë bërë në kategoritë adekuate.	Nuk është i aplikueshëm më
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha projektet për punë të përgatiten projektet ekzekutive si pjesë e specifikave teknike të projekteve, në mënyrë që të lehtësohet edhe realizimi i tyre konform kontratave	Nuk kemi hasur ndonjë rast të tillë.	I zbatuar
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të inicoj aprovimin e rregullave të brendshme për menaxhimin e pasurive për të qartësuar secilin aktivitet që lidhet me menaxhimin e pasurive. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë e komunës (përfshirë pasuritë kapitale dhe jo kapitale) janë regjistruar në regjistra dhe janë shpalosur saktë në PFV, në pajtim me kërkesat ligjore.	Komuna nuk kishte shpalosur të gjitha pasuritë nën 10,00€ në PFV .	Pjesërisht i zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore si dhe të shtojë kontrollet duke siguruar personel të Tatimit në Pronë që të bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit.
2.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë regjistruar në regjistra dhe janë shpalosur saktë në PFV, në pajtueshmëri me kërkesat ligjore .

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm




Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm




Faruk Rrahmani, Udhëheqës i Auditimit



Bahri Statovci, Udhëheqës i ekipit



Selvete Foniqi, Anëtare e ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Rufki Suma
Kryetari i komunës së Hanit të Elezit



Data: 12.07.2021



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.